



# **BYROJA KOSOVARE E SIGURIMEVE**

## **BULETIN INFORMATIV**

### **VI**

## **FONDI I KOMPENSIMIT**

**Prishtinë, Shkurt 2020**

## **Përmbajtja:**

Historiku i Fondit të Kompensimit ish Fondi i Garancisë së Kosovës .....	3
Statusi ligjor dhe struktura organizative – funksionale e Fondit të Kompensimit në kuadër të Byrosë Kosovare të Sigurimeve.....	3
Financimi i Fondit të Kompensimit në kuadër të Byrosë Kosovare të Sigurimeve.....	5
Procedurat e paraqitjes së kërkesës për kompensim të dëmit pranë Fondit të Kompensimit në kuadër të Byrosë Kosovare të Sigurimeve .....	6
Procedura me rastin e paraqitjes së dëmit: .....	6
E drejta ligjore e Fondit të Kompensimit në kuadër të Byrosë Kosovare të Sigurimit në rimbursimin e mjeteve financiare për dëmin e paguar .....	7
Numri i dëmeve të paguara në Fondin e Kompensimit – BKS.....	8
Numri i dëmeve të paguara në Fondin e Kompensimit .....	8
Mesatarja e dëmeve të paguara në Fondin e Kompensimit,.....	9
Numri i dëmeve të paraqitura dhe të rezervuara nga Fondi i Kompensimit .....	10
Struktura e dëmeve të paraqitura në Fondin e Kompensimit.....	11
Statistikat në numër dhe përqindje të dëmeve në varësi të Komunave ku ka ndodhur aksidenti .....	11
Pasqyra në mënyrë grafike sipas qyteteve e shprehur në përqindje për vitet 2014 – 2019	12
Dëmet nga automjetet me targa nga Republika e Serbisë dhe Malit të Zi.....	19
Dëmet e shkaktuara nga automjetet e paidentifikuara - dëmet NN .....	19
Dëmet nga makineritë bujqësore si traktorët, motoçikletat dhe multikultivatorët.....	20
Dëmet e shkaktuara nga veturat, autobusët, kamionët.....	20
Efekti i kostos së Dëmeve të Fondit të Kompensimit - BKS në zhvillimin e Industrisë së Sigurimeve. ....	23
Infrastruktura ligjore në Republikën e Kosovës lidhur me regjistrimin dhe sigurimin e automjeteve .....	24
Praktikat ligjore të vendeve të zhvilluara aplikimi i të cilave ka rezultuar me zvogëlimin e numrit të automjeteve të pasiguruara.....	24
Organizimi i aktivitetit intensiv lobues në zvogëlimin-ndalimin e numrit të automjeteve të pasiguruara.....	24
Propozimet/Masat të cilat do të ndikojnë në zvogëlimin e numrit të automjeteve të pasiguruara në Kosovë.....	25

## **Historiku i Fondit te Kompensimit ish Fondi i Garancisë së Kosovës**

Fondi i Garancisë së Kosovës është themeluar me dispozitat e Rregullores Nr. 1999/22, si akt ligjor i Administratës së Përkohshme të Misionit të Kombeve të Bashkuara dhe Nenit 4 të Rregullit 3 të datës 22.01.2003 bazuar mbi ndryshimin e Rregullit 3 për sigurimin e TPL - mjeteve motorike të datës 27.06.2002 i nxjerrë nga Banka Qendrore e Republikës së Kosovë (e quajtur BPK). Në statutin e Fondit të Garancisë, si akt juridik më i lartë i brendshëm i Fondit të Garancisë, themelues të Fondit të Garancisë janë Kompanitë e Sigurimeve të licencuara në Republikën e Kosovës për shitjen e sigurimit të Autopërgjegjësive - TPL.

Baza ligjore e funksionimit të ish Fondit të Garancisë ka qenë Rregulli 3 i cili ka qenë në fuqi deri me hyrjen në fuqi të Ligjit për Sigurimin e Detyrueshëm të Autopërgjegjësive nga Banka Qendrore e Republikës së Kosovës, në të cilin Rregull në Nenin 4 dhe 5 përshkruhen obligimet dhe të drejtat e Fondit të Garancisë si entitet ligjor. Fondi i Garancisë si entitet ligjor është subjekt juridik me të drejta të plota të përshkruara në Rregullin 3 dhe në Statutin e ish Fondit të Garancisë dhe konform këtyre akteve ka autorizime të plota ligjore për t'u paraqitur si subjekt juridik në qarkullimin juridik për realizimin e të drejtave të veta dhe për të qenë i kërkuar respektivisht i paditur për përmbushjen e obligimeve që kanë palët e drejta e të cilave buron nga Rregulli 3.

Themelues të Fondit të Garancisë se Kosovës janë Kompanitë e Sigurimeve të licencuara nga Banka Qendrore e Republikës së Kosovës për shitjen e sigurimeve të Autopërgjegjësive. Themelimi i Fondit ishte i rregulluar në Nenin 4 pika 4.2 të Rregullit 3 deri në miratimin e Ligjit për Sigurimin e Detyrueshëm nga Autopërgjegjësia.

## **Statusi ligjor dhe struktura organizative – funksionale e Fondit të Kompensimit në kuadër të Byrosë Kosovare të Sigurimeve**

a) Fondi i Kompensimit në Byronë Kosovare të Sigurimeve është paraparë me dispozitat e Ligjit për Sigurimin e Detyrueshëm nga Autopërgjegjësia, i cili është miratuar në Kuvendin e Republikës së Kosovës përkatësisht me datën 23.06.2011 dhe ka hyrë në fuqi 15 ditë pas publikimit të të njëjtit në gazetën zyrtare të Republikës së Kosovës. Me hyrjen në fuqi të këtij Ligji konkretisht në Nenin 43 të tij, janë përshkruar dispozitat kalimtare ku është përcaktuar edhe shfuqizimi i çdo dispozite të rregullores së UNMIKUT 2001/25 mbi bazën e së cilës ka funksionuar ish Fondi i Garancisë së Kosovës kur janë në kundërshtim me këtë Ligj. Praktikisht Fondi i Kompensimit i themeluar me Ligj edhe më tutje funksionon mbi principet e njëjta që ka funksionuar edhe Fondi i Garancisë së Kosovës, dhe është pas-ardhës juridik i Fondit të Garancisë së Kosovës, ku edhe ka trashëguar kontestet nga ish Fondi i Garancisë së Kosovës. Në Kreun 3 të Ligjit për Sigurimin e Detyrueshëm nga Autopërgjegjësia, ku janë përcaktuar statusi, funksionimi, organizimi dhe raportimi i Byrosë Kosovare të Sigurimeve, në Nenin 29 par. 6 të Ligjit për Sigurimin e Detyrueshëm nga Autopërgjegjësia, është përcaktuar se Byroja Kosovare e Sigurimeve kryen funksionin e Fondit të Kompensimit për pagesën e dëmeve të parashikuara me këtë ligj, me mjetet nga Fondi i Kompensimit.

Prandaj, Fondi i Kompensimit administrohet nga Byroja Kosovare e Sigurimit dhe ka për qëllim pagesën e dëmeve në territorin e Republikës së Kosovës, në rastet kur shkaktarët e aksidenteve janë të pasiguruar, në rastet kur shkaktarët e aksidenteve janë të pidentifikuar, në rastet kur shkaktarët e aksidenteve janë me regjistrim të huaj dhe ju ka skaduar Sigurimi Kufitar, të përcaktuara më në detaje në Nenin 18, 19, 20, 21, dhe 22 të Ligjit për Sigurimin e Detyrueshëm nga Autopërgjegjësia.

Siguruesit të cilët ushtrojnë veprimtari në Sigurimin e Detyrueshëm nga Autopërgjegjësia në territorin e Republikës së Kosovës, janë të detyruar që të kontribuojnë çdo tre muaj financiarisht në Fondin e Kompensimit, në përpjesëtim të drejtë me primet e realizuara në këto lloj sigurimesh në tre mujorin pas-ardhës sipas Nenit 32 par. 2 e Ligjit për Sigurimin e Detyrueshëm nga Autopërgjegjësia.

Po në këtë Ligj, përkatësisht në Nenin 32 par. 3 janë përcaktuar edhe burime tjera të Fondit të Kompensimit e që janë arkëtime prej rimbursimit në procedurat e regresit; kontributet shtesë të siguruesve, kur fondi i parashikuar rezulton të jetë i pamjaftueshëm për të kryer pagesat; rimbursimet nga pronarët e mjeteve motorike të pasiguruara për të cilët Fondi i Kompensimit ka paguar dëmshpërblim; të ardhurat nga investimi i mjeteve të Fondit të Kompensimit; burimet e tjera, të cilat nuk ndalohen me ligj.

Para kontributit të siguruesve në Fondin e Kompensimit BQK-ja, me propozimin e Byrosë, çdo vit vendos shumën e kontribuesve që të njëjtit duhet ta paguajnë, si dhe afatin brenda të cilit duhet të bëhet financimi i mjeteve.

Është e ndaluar që kërkesat nga Fondet pensioneve, invalidore, dhe shëndetësore të rimbursohen nga Fondi i Kompensimit.

Shtetasve të huaj u njihet e drejta në dëmshpërblim për dëmet që paguhen nga Fondi i Kompensimit, përveç, në rastet kur kjo e drejtë nuk u njihet shtetasve Kosovar me Ligjin e shtetit të cilit i përket i dëmtuari.

Fondit i Kompensimit mbahet i veçante në llogaritë e përcaktuara nga BQK brenda territorit të Republikës së Kosovës, por është paraparë mundësia që mjetet nga Fondi i Kompensimit të mund të investohen në letra me vlerë të Qeverisë si dhe në depozita bankare. Byroja e Sigurimeve është e obliguar që për çdo muaj të paraqes pranë BQK-se raportin e gjendjes së aktives në mbulimin e Fondit të Kompensimit, po ashtu është e obliguar që ta njoftoj BQK-ne kur siguruesi vepron në kundërshtim me dispozitat e Ligjit për Sigurimin e Detyrueshëm nga Autopërgjegjësia, në rast të mosrespektimit të obligimeve nga ana e Siguruesve.

Ligji për Sigurimin e Detyrueshëm po ashtu ka paraparë edhe masat ndëshkuese deri tek revokimi i licencës për veprimtarinë e Sigurimit të Detyrueshëm.

b) Struktura organizative e Fondit të Kompensimit së Kosovës është e rregulluar me Statutin e Byrosë Kosovare të Sigurimeve si akti më i lartë i brendshëm. Udhëheqja e Byrosë Kosovare të Sigurimeve - Fondit të Kompensimit – organet drejtuese të saj janë të parapara në Nenin 30 të Ligjit për Sigurimin e Detyrueshëm nga Autopërgjegjësia në të cilën përshkruhet se Byroja Kosovare e Sigurimeve - Fondi i Kompensimit drejtohet nga Asambleja e Përgjithshme, Këshilli Administrativ, Drejtori Ekzekutiv. Në mbështetje të Ligjit për Sigurimin e Detyrueshëm nga Autopërgjegjësia, Byroja Kosovare e Sigurimeve - Fondi i Kompensimit ka nxjerr edhe Statutin ku në detaje përshkruhen të drejtat dhe obligimet e organeve vendimmarrëse dhe ekzekutive të Byrosë Kosovare të Sigurimeve – Fondit të Kompensimit. Asambleja e Përgjithshme dhe Këshilli Administrativ konform dispozitave të Statutit në koordinim me Drejtorin Ekzekutiv e udhëheqin aktivitetin e Fondit duke i koordinuar të gjitha përgjegjësitë dhe të drejtat e të cilat në mbledhjet e rregullta sipas statutit shqyrtohen dhe miratohen. Byroja Kosovare e Sigurimeve ka Drejtorin Ekzekutiv i cili zgjidhet konform dispozitave të Statutit dhe të drejtat si dhe detyrimet e Drejtorit janë gjithashtu të përshkuara në dispozitat e Statutit. Byroja Kosovare e Sigurimeve më tutje ka Departamentin Ligjor dhe Dëmeve, Sigurimin Kufitar, Departamentin e Financave dhe Administratës, Departamentin MOU, dhe Departamentin e Qendrës Informative.

### **Financimi i Fondit të Kompensimit në kuadër të Byrosë Kosovare të Sigurimeve**

Siguruesit të cilët ushtrojnë veprimtari në sigurimin e detyrueshëm në territorin e Republikës së Kosovës, janë të detyruar të kontribuojnë çdo tre (3) muaj financiarisht në Fondin e Kompensimit, në përpjesëtim të drejtë me primet e realizuara në këto lloj sigurimesh në tre mujorin paraardhës. Por në Ligjin për Sigurimin e Detyrueshëm nga Autopërgjegjësia janë paraparë edhe burime tjera të Fondit të Kompensimit e që janë: arkëtime prej rimbursimit në procedurat e regresit; kontributet shtesë të siguruesve, kur fondi i parashikuar rezulton të jetë i pamjaftueshëm për të kryer pagesat, rimbursimet nga pronarët e mjeteve motorike të pasiguruara për të cilët Fondi i Kompensimit ka paguar dëmshpërblim; të ardhurat nga investimi i mjeteve të Fondit të Kompensimit, burimet e tjera, të cilat nuk ndalohen me ligj.

BQK-ja në cilësi të Mbikëqyrësit mbi Industrinë e Sigurimeve, me propozimin e Byrosë, vendos çdo vit shumën e kontributeve të Kompanive të Sigurimit në Fondin e Kompensimit e cila administrohet nga Byroja Kosovare e Sigurimit, si dhe afatin brenda të cilit duhet të bëhet derdhja e mjeteve, Fondi i Kompensimit mbahet i veçantë në llogaritë e përcaktuara nga BQK brenda territorit të Republikës së Kosovës. Fondi i Kompensimit mund të investohet në letra me vlerë të Qeverisë dhe depozita bankare. BQK, si organ mbikëqyrës i Industrisë së Sigurimevenxjerr rregulla shtesë për mënyrën e mbajtjes dhe të përdorimit të aktives në mbulim të këtyre fondeve. Byroja i paraqet BQK-së, çdo muaj raportin për gjendjen e aktives në mbulim të Fondit të Kompensimit. Byroja është e detyruar të njoftoj menjëherë BQK-në, kur siguruesi vepron në kundërshtim me dispozitat e këtij ligji, përkitazi me detyrimet e financimit të Fondit të Kompensimit.

Kur siguruesi nuk ka zbatuar detyrimet e parashikuara në këtë ligj për financimin e Fondit të Kompensimit, BQK i revokon siguruesit licencën për veprimtarinë e sigurimit të detyrueshëm.

### **Procedurat e paraqitjes së kërkesës për kompensim të dëmit pranë Fondit të Kompensimit në kuadër të Byrosë Kosovare të Sigurimeve**

Lidhur me dëmet të cilat shkaktohen nga automjetet e paregjistruara dhe pasiguruara, fillimisht, procedohet me një proces nga Policia e Trafikut mbi bazën e të cilit identifikohet edhe shkaktri i dëmit. Më pas, pas pranimit të kërkesës për dëmshpërblim pranë Departamentit të Dëmeve tek Byroja Kosovare e Sigurimit brenda afatit ligjor dhe brenda rregullores për procedurat e trajtimit të kërkesave për kompensim demi – rregullore e nxjerrur nga Banka Qëndrore e Republikës së Kosovës, komisioni trajtues është i obliguar për vlerësimin dhe trajtimin e dëmit ndaj palëve të dëmtuara për aksidentin e raportuar pranë këtij Fondi. Pas pagesës së dëmit, zyrtarët përkatës të Byrosë Kosovare të Sigurimit - ftojnë shkaktrin e dëmit dhe e informojnë për pagesën dhe i japin mundësi që dëmin e paguar nga Fondi i Kompensimit, shkaktri i dëmit ta kompensoj në rrugë jashtëgjyqësore duke i krijuar mundësi që lartësinë e dëmit ta paguaj me këste në shuma më të vogla. Nëse shkaktri i dëmit nuk ndërmerr veprimin për të filluar me pagesën e shumës së dëmit të cilin Fondi i Kompensimit i'a ka paguar për fajin e tij palës së tretë atëherë zyrtarët e Fondit iniciojnë procedurën e regresimit të dëmit në rrugë gjyqësore.

### **Procedura me rastin e paraqitjes së dëmit:**

1. Trajtimi i dëmeve nga sigurimi i Autopërgjegjesisë bëhet nga Siguruesi, në këtë rast Byroja Kosovare e Sigurimit – Fondi i Kompensimit, ku shkaktri i dëmit është pasigurim.
2. Siguruesit mund të lidhin marrëveshje sipas të cilës kërkesa për dëmshpërblim nga baza e sigurimit të Autopërgjegjesisë mund t'i parashtrohet dhe të trajtohet nga siguruesi i drejtpërdrejtë.
3. Kërkesën për kompensimin e dëmit e pranon personi i autorizuar nga Siguruesi. Me rastin e pranimit të kërkesës për kompensim demi, personi i autorizuar ka për detyrë që ta verifikoj vlefshmërinë e mbulesës sigurorese.
4. Kërkesa për kompensim bëhet në formë të shkruar nga i dëmtuari personalisht, përmes përfaqësuesit ligjor apo nga i autorizuari i tij.
5. Nëse kërkesa e parashtruar nuk është e kompletuar me prova dhe dokumentacion të nevojshëm për të vendosur për kompensimin, Siguruesi është i detyruar që brenda afatit prej tre (3) ditësh nga dita e pranimit të kërkesës për kompensim, të njoftoj me shkrim të dëmtuarin, përfaqësuesin ligjor apo të autorizuarin e tij, duke precizuar se me cilat prova dhe dokumentacion duhet plotësuar kërkesa e tij.
6. Kërkesa për kompensim demi duhet të paraqitet në zyrën qendrore apo në degët e Siguruesit në njërin nga mënyrat si më poshtë; drejtpërdrejtë; me postë, me postë elektronike (email) dhe me faks.

7. Kërkesa për kompensimin e dëmit bëhet me plotësimin e *formularit unik* “Paraqitja e kërkesës për kompensimin e dëmit nga sigurimi i Autopërgjegjësise”.

8. Nëse i dëmtuari apo përfaqësuesi i tij ka parashtruar kërkesën përmes postës elektronike (emal) ose faksit, plotësimi i formularit të përmendur në paragrafin 7 të këtij neni nuk është i nevojshëm. Në raste të tilla, Siguruesi obligohet që brenda afatit prej tre (3) ditësh ta njoftoj paraqitësin e kërkesës për kompensim dëmi që të sjellin në formë fizike dokumentacionin e nevojshëm origjinal.

9. Kur personi i autorizuar i Siguruesit e pranon formularin mbi kërkesën e shkruar për kompensim dëmi, ai është i obliguar që:

a) Ta rishikoj formularin e plotësuar (Paraqitja e kërkesës për kompensimin e dëmit nga sigurimi i Autopërgjegjësise), ta verifikoj rregullsinë e plotësimin, të konstatoj nëse është e qartë se kush është pjesëmarrës në aksident, nëse është dhënë përshkrimi detaj i rrjedhës së ngjarjes dhe skicimi i aksidentit si dhe nëse është i nënshkruar formulari.

Në rast se formulari i plotësuar është i pakuptueshëm ose nuk është plotësuar me të dhënat e kërkuara, do t’i kërkohet paraqitësit të kërkesës që ta plotësoj edhe një herë formularin.

b) Me nënshkrimin e formularit nga pala e dëmtuar vërtetohen të dhënat e paraqitura në kërkesën për kompensim të dëmit.

c) Siguruesi mund të kërkoj të caktohet vendi dhe koha e shikimit – vlerësimit të dëmit material, bashkërisht me të dëmtuarin.

d) Dokumentacioni për kompensim dëmi do të mbahet në dy kopje, njëra kopje mbahet nga Siguruesi, kurse kopja tjetër mbahet nga i dëmtuari apo i autorizuari i tij.

10. Për mënyrën e kompensimit të dëmit në mjete motorike pala e dëmtuar informohet për mundësitë e kompensimit si më poshtë:

a) Sipas marrëveshjes mes palëve, në bazë të faturave të riparimit

b) me firmosje të pëlqimit të palës së dëmtuar që riparimi të realizohet dhe paguhet nga siguruesi në njërën nga serviset me të cilat Siguruesi ka kontratë bashkëpunimi.

### **E drejta ligjore e Fondit të Kompensimit në kuadër të Byrosë Kosovare të Sigurimit në rimbursimin e mjeteve financiare për dëmin e paguar**


Byroja Kosovare e Sigurimit - Fondi i Kompensimit, si entitet ligjor, pas përmbushjes së obligimeve konform Ligjit për Sigurimin e Detyrueshëm dhe rregullores së BQK-së për procedurat e trajtimit të dëmeve, ka edhe të drejtën ligjore konform Nenit 3 pika 4 dhe Nenit 14 pika 3 të Ligjit për Sigurimin e Detyrueshëm që nga shkaktari i dëmit të kërkoj rimbursimin e mjeteve financiare të cilat i ka paguar për dëmin të cilin e ka shkaktuar personi përgjegjës i cili automjetin e ka shfrytëzuar në trafik në kundërshtim me rregullat ligjore për ta regjistruar dhe siguruar. Nga kërkesat për rimbushim si ato jashtëgryqësore por edhe ato në procedura gjyqësore shuma e regresit është në disproporcion shumë të madh dhe atë nga shumë faktor duke filluar nga gjendja materiale-pamundësia e shkaktarit të dëmit që ta marrë përsipër pagesën e shumës së dëmit të paguar, tej zgjatja e procedurave gjyqësore e deri tek mohimi i fakteve mbi bazën e të cilave është shkaktuar aksidenti dhe llogaritja e lartësisë së dëmit.

## Numri i dëmeve të paguara në Fondin e Kompensimit – BKS


### Numri i dëmeve të paguara në Fondin e Kompensimit

Në fillim të periudhës së themelimit të Fondit të Kompensimit, ka qenë numër i arsyeshëm dhe konform parametrave të pritshme që i kanë edhe vendet me një sistem dhe infrastruktura ligjore shumë më të përparuara se Republika e Kosovës. Në tabelën në vijim mund ta shini trendin e numrit të dëmeve të paguara në vite dhe shumat e paguara, shifra shqetësuese për BKS-FK, i cili trend ka arritur shkallën alarmuese, ku si efekt mundet të dëmtohet seriozisht Industria e Sigurimeve duke u bërë barrë financiare.

Viti	Numri i dëmeve	Shuma e paguar
2010	2,255	3,253,561
2011	2,016	3,141,632
2012	2,139	3,500,529
2013	2,345	3,756,892
2014	1,891	2,793,903
2015	1,447	3,229,362
2016	1,546	3,336,484
2017	1,992	3,318,244
2018	1,765	3,399,661
2019	1,796	4,436,461
<b>TOTAL:</b>	<b>19,192</b>	<b>34,166,729</b>







### Mesatarja e dëmeve të paguara në Fondin e Kompensimit,

E paraqitur në mënyrë tabelore tregon për lëvizjen e mesatares së dëmeve të paguara sipas natyrës së dëmit të trajtuar si dhe vendit të trajtimit (dëmet në procedurë gjyqësore si dhe dëmet në procedurë jogjyqësore). Bazuar në statistikat lidhur me lartësinë e dëmeve të trajtuara e të paguara në këto vite të zhvillimit të industrisë së sigurimeve, mesatarja e një dëmi të paguar në procedurë jogjyqësore në vitin 2018 është rreth 1,014.00 Eur, ndërsa, në procedurë gjyqësore rreth 7,752.00 Eur. Duke analizuar të dhënat mund të konstatojmë deri tek konkludimi i kostos së Industrisë së Sigurimeve për të përballuar Fondin e Kompensimit duke i shtuar edhe shpenzimet tjera si rezervat, risigurimi dhe shpenzimet e administrimit të Fondit.

Në tre tabelat si më poshtë janë të paraqitura dëmet e paguara dhe mesatarja, e ndarë në: \* Dëmet në procedure jashtëgjyqësore, \*\* Dëmet në gjykata, dhe \*\*\* Total të paguara.

\* Dëmet në procedurë jashtëgjyqësore.

EMRI	VIII 2015			VIII 2016			VIII 2017			VIII 2018			VIII 2019		
	NR.	PAGUAR	MES.	NR.	PAGUAR	MES.	NR.	PAGUAR	MES.	NR.	PAGUAR	MES.	NR.	PAGUAR	MES.
DËME NË AUTOMJETE	834	755,750	906	816	700,194	858	926	865,770	935	857	779,147	909	840	844,571	1,005
DËME NË PASURI TJETËR	9	3,657	406	21	10,817	515	20	20,694	1,035	17	17,416	1,024	19	20,837	1,097
DËME ME LËNDIM	450	655,686	1,457	477	581,721	1,220	825	865,874	1,050	647	647,186	1,000	546	521,183	955
DËME ME VDEKJE	5	64,971	12,994	5	121,310	24,262	4	78,285	19,571	5	103,198	20,640	3	86,390	28,797
<b>TOTAL:</b>	<b>1298</b>	<b>1,480,062</b>	<b>1,140</b>	<b>1319</b>	<b>1,414,043</b>	<b>1,072</b>	<b>1775</b>	<b>1,830,623</b>	<b>1,031</b>	<b>1526</b>	<b>1,546,948</b>	<b>1,014</b>	<b>1408</b>	<b>1,472,981</b>	<b>1,046</b>

**\*\* Dëmet në gjykata**

EMRI	VIII 2015			VIII 2016			VIII 2017			VIII 2018			VIII 2019		
	NR.	PAGUAR	MES.	NR.	PAGUAR	MES.	NR.	PAGUAR	MES.	NR.	PAGUAR	MES.	NR.	PAGUAR	MES.
DËME NË AUTOMJETE	20	47,171	2,359	27	38,060	1,410	34	87,712	2,580	41	169,039	4,123	61	215,430	3,532
DËME NË PASURI TJETËR	2	28,491	14,246	3	7,125	2,375	3	8,391	2,797	1	2,800	2,800	5	34,776	6,955
DËME ME LËNDIM	120	1,337,076	11,142	180	1,594,698	8,859	170	1,148,527	6,756	185	1,405,133	7,595	303	2,091,194	6,902
DËME ME VDEKJE	7	336,562	48,080	10	271,419	27,142	10	242,992	24,299	12	275,741	22,978	19	622,080	32,741
<b>TOTAL:</b>	<b>149</b>	<b>1,749,300</b>	<b>11,740</b>	<b>220</b>	<b>1,911,302</b>	<b>8,688</b>	<b>217</b>	<b>1,487,622</b>	<b>6,855</b>	<b>239</b>	<b>1,852,713</b>	<b>7,752</b>	<b>388</b>	<b>2,963,480</b>	<b>7,638</b>

**\*\*\*Total të paguara**


EMRI	VIII 2015			VIII 2016			VIII 2017			VIII 2018			VIII 2019		
	NR.	PAGUAR	MES.	NR.	PAGUAR	MES.	NR.	PAGUAR	MES.	NR.	PAGUAR	MES.	NR.	PAGUAR	MES.
DËME NË AUTOMJETE	854	802,920	940	843	738,255	876	960	953,482	993	898	948,187	1,056	901	1,060,001	1,176
DËME NË PASURI TJETËR	11	32,148	2,923	24	17,942	748	23	29,085	1,265	18	20,216	1,123	24	55,613	2,317
DËME ME LËNDIM	570	1,992,762	3,496	657	2,176,419	3,313	995	2,014,401	2,025	832	2,052,319	2,467	849	2,612,377	3,077
DËME ME VDEKJE	12	401,533	33,461	15	392,729	26,182	14	321,277	22,948	17	378,939	22,291	22	708,470	32,203
<b>TOTAL:</b>	<b>1447</b>	<b>3,229,362</b>	<b>2,232</b>	<b>1539</b>	<b>3,325,345</b>	<b>2,161</b>	<b>1992</b>	<b>3,318,245</b>	<b>1,666</b>	<b>1765</b>	<b>3,399,661</b>	<b>1,926</b>	<b>1796</b>	<b>4,436,461</b>	<b>2,470</b>

**Numri i dëmeve të paraqitura dhe të rezervuara nga Fondi i Kompensimit**

Numri i dëmeve të paraqitura në Fondin e Garancisë – Kompensimit sikurse tek dëmet e paguara në vitet e para pas themelimit ka qene numër i arsyeshëm konform parametrave të pritshme. Në tabelën në vijim mund ta shini trendin e numrit të dëmeve ndër vite duke u rritur deri në shifra shqetësuese viti 2013, në vitin 2014 dhe në vijim kemi rënje të rasteve të raportuara, në vitin 2017 kemi rritje të rasteve të raportuara, ndërsa, në vitin 2018 bazuar në rastet e raportuara trendi është në rënie.

*Numri i dëmeve të paraqitura sipas viteve të prezentuara në mënyrë tabelare dhe grafike.*

Viti	Numri i dëmeve të paraqitura
2015	2,128
2016	2,099
2017	2,354
2018	2,124
2019	2,105



### Shuma e rezervuar e dëmeve pezull (rezervat e dëmeve), sipas viteve:

Viti	Shuma e rezervuar në euro
2015	13,070,619
2016	13,517,267
2017	8,315,705
2018	9,799,024
2019	9,117,768

### Struktura e dëmeve të paraqitura në Fondin e Kompensimit


#### Statistikat në numër dhe përqindje të dëmeve në varësi të Komunave ku ka ndodhur aksidenti

Në mënyrë që masat eventuale administrative dhe preventive të merren nga organet shtetërore kompetenca e të cilave është regjistrimi i automjeteve dhe implementimi i Ligjit mbi Sigurinë në Trafik, në tabelën në vijim e kemi paraqitur numrin e aksidenteve nga automjetet e paregjistruara dhe vendin e aksidentit/komunen ku është shkaktuar aksidenti rrugor. Nga numri dhe përqindjet të cilat janë detalizuar në tabelën dhe grafikun, mund të shihet se qyteti i Prishtinës, fatkeqësisht, në çdo vit avancohet me numrin më të madh të aksidenteve nga automjetet të cilat nuk regjistrohen dhe as nuk sigurohen.


Pasqyra në mënyrë grafike sipas qyteteve e shprehur në përqindje për vitet 2014 – 2019

Qyteti	2015	2016	2017	2018	2019
Kos	49	1	2	4	1
Deçan	38	46	41	30	36
Dragash	1	6	13	1	13
Ferizaj	114	135	118	118	108
Fushë Kosovë	90	87	92	38	52
Gjakovë	77	68	63	69	83
Gjilan	79	66	83	76	71
Gllogovc	95	112	94	79	100
Graçanicë	14	10	11	11	18
Hani i Elezit	3	0	4	14	5
Istog	44	40	40	36	55
Junik	1	4	0	1	4
Kamenicë	20	16	13	8	10
Kaçanik	18	31	31	28	35
Klinë	59	56	56	42	51
Kllokot	2	4	7	8	0
Leposaviq	4	1	3	1	0
Lipjan	61	72	75	91	84
Malishevë	85	53	60	50	71
Mamusha	3	1	0	0	0
Mitrovicë e Jugut	76	86	107	96	88
Mitrovicë e Veriut	2	3	7	1	2
Novobërdë	5	2	2	4	5
Obiliq	23	30	9	24	23
Partesh	2	1	0	0	2
Pejë	176	144	203	224	201
Podujevë	182	174	169	159	155
Prishtinë	412	397	613	494	423
Prizren	122	120	128	121	126
Rahovec	32	29	32	29	36
Ranilluk	0	2	0	0	0
Shtime	25	29	24	35	23
Shtërpce	8	5	8	8	5
Skenderaj	31	51	52	53	62
Suharekë	54	78	58	49	60
Viti	40	36	40	34	31
Vushtrri	79	100	91	86	66
Zubin Potok	0	0	2	1	0
Zveçan	2	3	4	1	0
<b>TOTAL:</b>	<b>2,128</b>	<b>2,099</b>	<b>2,355</b>	<b>2,124</b>	<b>2,105</b>


## Dëmet sipas qyteteve të shprehura në përqindje për vitin 2014




## Dëmet sipas qyteteve të shprehura në përqindje për vitin 2015



### Dëmet sipas qyteteve të shprehura në përqindje për vitit 2016




### Dëmet sipas qyteteve të shprehura në përqindje për vitit 2017






### Dëmet sipas qyteteve të shprehura në përqindje për 2018



### Dëmet sipas qyteteve të shprehura në përqindje për 2019



## Dëmet nga automjetet me targa nga Republika e Serbisë dhe Malit të Zi

Deri me hyrjen në fuqi të Marrëveshjes së Mirëkuptimi ndërmjet shtetit të Kosovës dhe shtetit të Serbisë përse i përket aksidenteve rrugore - Industria e Sigurimeve, ka bartur një barrë të padrejtë për kompensimin e dëmeve të shkaktuara nga automjetet me sigurim nga kompanitë serbe për faktin se në një periudhë të gjatë kohore për arsye të ndryshme të njëjtat automjete nuk i'u kanë nënshtruar fare pagesës së Sigurimit Kufitar. Gjithashtu, të njëjtën barrë e ka bartur edhe ndaj automjeteve të siguruara nga kompanitë e sigurimit të shtetit Malazez - për arsye se të njëjtat po ashtu nuk i'u kanë nënshtruar Sigurimit të Detyrueshëm Kufitar. Pra, këto automjete të cilat pasigurim kanë qarkulluar nëpër rrugët e Kosovës në rastin e aksidentit Byroja Kosovare e Sigurimeve - Fondi i Kompensimit obligohet me ligj t'i kompensoj palët e treta në rastin kur automjeti shkaktar është pasigurim.

Për të qenë sa më transparent kemi dhënë një pasqyrë të kostos të cilën Industria e Sigurimeve në Kosovë e ka bartur ndërvite deri në hyrjen në fuqi të Marrëveshjes së Mirëkuptimit me shtetin Serb dhe pasqyrat e dëmeve për aksidentet e shkaktuara nga automjetet e Malit të Zi nga 2010 deri më 2016.

ME TABELA - SERBI	2010	2011	2012	2013	2014	2015	2016
Numri i dameve te paraqitura	139	218	86	99	32	22	3
Numri i dameve te paguara	154	175	109	91	44	21	8
Shuma e paguar	164,718	207,735	234,759	161,700	63,811	39,683	8,882

ME TABELA - MALI I ZI	2010	2011	2012	2013	2014	2015	2016
Numri i dameve te paraqitura	49	49	18	16	3	9	4
Numri i dameve te paguara	62	35	26	18	9	7	8
Shuma e paguar	92,935	65,948	50,395	61,536	33,616	11,974	9,422

## Dëmet e shkaktuara nga automjetet e paidentifikuara - dëmet NN

Personi fizik i dëmtuar të cilit i është shkaktuar dëmi nga përdorimi i mjetit motorik të paidentifikuar, ka të drejtë të parashtrijë kërkesën për dëmshpërblim pranë Byrosë.

Personi fizik i dëmtuar ka të drejtë dëmshpërblimi për dëmet që vijnë si rezultat i vdekjes, dëmtimeve trupore apo përkeqësimit të shëndetit deri në shumën e përcaktuar në Nenin 13 të Ligjit të Autopërgjegjësisë. I dëmtuari ka të drejtë të kërkoj dëmshpërblim për dëmet në sende, duke përjashtuar dëmet në mjete motorike, të shkaktuara nga përdorimi i mjetit motorik të paidentifikuar, deri në shumën e përcaktuar në nenin 13 të ligjit të Autopërgjegjësisë.

I dëmtuari ka për detyrim që dëmin e shkaktuar nga mjete motorik i paidentifikuar, t'ia raportojë policisë së trafikut rrugor, në afat prej shtatë (7) ditësh në rast të dëmit në pasuri dhe në afat prej tridhjetë (30) ditësh në rast të dëmit në persona nga dita e aksidentit. I dëmtuari gjithashtu ka për detyrim të paraqes rastin në Byro në afat prej nëntëdhjetë (90) ditësh.

Tabela si më poshtë, jep detajet për numrin e dëmeve NN, i cili fatkeqësisht ka shkuar në rritje që nga fillimi dhe ende është në shifra shqetësuese.

DËMET NN	2014	2015	2016	2017	2018	2019
Numri i dëmeve të paraqitura	146	132	146	188	204	164
Numri i dëmeve të paguara	80	58	58	99	108	102
Shuma e paguar	210,676	281,746	179,988	181,847	355,356	267,999

### Dëmet nga makineritë bujqësore si traktorët, motoçikletat dhe multikultivatorët

Makineritë bujqësore të cilët kryesisht shfrytëzojnë trafikun për punë dhe nevoja bujqësore shpesh shkaktojnë edhe dëme në trafik me pasoja të konsiderueshme në njerëz dhe dëme materiale. Ndonëse makineritë bujqësore/traktorët janë të obliguar të sigurohen, pronarët e tyre në 99% të rasteve nuk e përmbushin këtë obligim ligjor dhe dalin në trafik pa u siguruar. Motoçikletat të cilat gjithashtu e shtojnë në numër të konsiderueshëm numrin e dëmeve të cilat Fondi i Kompensimit duhet t'i paguaj, gjithashtu, nuk e përmbushin obligimin ligjor për t'u siguruar dhe fatkeqësisht gjatë shfrytëzimit të trafikut shkaktojnë edhe dëme me pasoja të konsiderueshme financiare.

Tabela si më poshtë, jep detajet për numrin e dëmeve të kategorizuara nga makineritë bujqësore dhe motoçikletat.

DEMET MEMJETE PUNE DHE MOTOQIKLETA	2014	2015	2016	2017	2018	2019
Numri i dëmeve të paraqitura	314	323	253	291	292	251
Numri i dëmeve të paguara	262	213	145	258	219	213
Shuma e paguar	354,690	349,194	314,360	376,067	431,823	607,746


### Dëmet e shkaktuara nga veturat, autobusët, kamionët


DËMET ME VETURA KAMION E AUTOBUS	2014	2015	2016	2017	2018	2019
Numri i dëmeve të paraqitura	1,685	1,642	1,590	1,876	1,628	1,690
Numri i dëmeve të paguara	1,496	1,148	1,224	1,635	1,438	1,481
Shuma e paguar	2,131,110	2,546,765	2,665,388	2,760,330	2,612,482	3,560,716

Në tabelën dhe grafikët si mëposhtë mund të shihet pjesëmarrja e kategorive të dëmeve të paraqitura në totalin e dëmeve në Fondin e Kompensimit.

- Me tabela të Serbisë,
- Me tabela të Malit të Zi,
- Dëmet me traktor dhe motoçikleta,
- Dëmet me vetura e kamionë (të gjitha kategoritë e mjeteve tjera)

VITET	2015	2016	2017	2018	2019
ME TABELA - SERBI	22	3	0	0	0
ME TABELA - MALI I ZI	9	4	0	0	0
DËMET - NN	132	146	188	204	164
DËMET ME TRAKTOR E MOTOÇIKLETA	323	356	291	292	251
DËMET ME VETURA E KAMION	1642	1590	1876	1628	1690
<b>TOTAL:</b>	<b>2128</b>	<b>2099</b>	<b>2355</b>	<b>2124</b>	<b>2105</b>






Në tabelën në vijim është paraqitur shuma e rimbursimit

Byroja Kosovare e Sigurimit, ka parashtruar një numër të madh të padive të regresit ndaj personave përgjegjës të aksidenteve. Rezulton se një numër i madh i tyre është në proces gjyqësor që përfaqësohen si raste nga përfaqësuesit ligjor pranë gjykatave me qëllim realizimin me sukses të kontesteve të rimbursimit.

Tabela si më poshtë jep detaje mbi rimbursimin e shumave deri më tani:

Viti	Shuma e rimbursuar
2012	2,266
2013	4,986
2014	14,174
2015	27,184
2016	24,456
2017	40,832
2018	109,869
2019	147,377
<b>TOTAL:</b>	<b>371,144</b>



### **Efekti i kostos së Dëmeve të Fondit të Kompensimit - BKS në zhvillimin e Industrisë së Sigurimeve.**

Bazuar në statistikat e prezantuara si më sipër, mund të konstatohet se Byroja Kosovare e Sigurimit nga fillimi i funksionimit të tij në vite është zhvilluar dhe është financuar prej Kompanive të Sigurimeve. Trendi i rritjes së automjeteve të cilat nuk regjistrohen dhe nuk sigurohen aktualisht ka arritur në shifër shqetësuese. Numri i madh i automjeteve të cilat nuk regjistrohen dhe nuk sigurohen fillimisht e ul kapacitetin financiar të portofolios së sigurimit TPL (Autopërgjegjesisë) d.m.th. Kompanitë realizojnë prime shumë më pak, janë të obliguar ligjërisht të bartin rrezik në mënyrë të padrejtë t’i mbulojnë dëmet nga këto automjete, pronarët e të cilëve shkelin ligjin mbi Sigurinë në Trafik, duke mos përfillur obligimin ligjor që të dalin në trafik me automjete të regjistruara dhe të siguruara.

Në bazë të kalkulimeve të pjesëmarrjes së dëmeve në prime tek policat e rregullta, del se numri i dëmeve nga automjetet e pasiguruara na jep një shifër që i afrohen 30,000.00 automjeteve të cilët qarkullojnë në rrugët e Kosovës pa regjistrim dhe pasigurim. Nga ky numër i automjeteve të pasiguruara/regjistruara Industria e Sigurimeve fillimisht i humb mbi 4.5 mil euro prime nga i cili prim një pjesë do ta përfitonte edhe buxheti i Republikës së Kosovës. Nëse i shtohen edhe humbjet për dëme që se bashku me rezervat arrin në 13 milo euro në Fondin e Kompensimit, atëherë, jemi pranë një rezultati ku Industria e Sigurimeve është duke bartur rrezik pa realizuar primet në shumën rreth 20 mil euro ne vit.

Nga të dhënat e më sipër, konsistojmë qartë se sa e rëndë është situata për Industrinë e Sigurimeve, e cila përtej shifrave ndaj humbjeve të larta financiare kjo gjë dukshëm paraqet pengesë edhe ndaj anëtarësimit të Kosovës drejtë Sistemit të Kartonit të Gjellbër.

## **Infrastruktura ligjore ne Republikën e Kosovës lidhur me regjistrimin dhe sigurimin e automjeteve**

Regjistrimi i automjeteve në Kosovë bëhet në Qendrat për Regjistrim të Automjeteve në kuadër të ARC-së dhe Ministrisë së Punëve të Brendshme. Automjetet në pronësi të personave fizik regjistrohen në bazë të vendbanimit apo vendqëndrimit të pronarit, ndërsa, automjetet në pronësi të personave juridik regjistrohen në bazë të certifikatës së biznesit.

Procedura e regjistrimit të automjeteve në Republikën e Kosovës bëhet sipas Udhëzimit Administrativ Nr. 14/2009 – MPB për Regjistrimin e Automjeteve, të nxjerrur nga Ministria e Punëve të Brendshme.

### **Praktikat ligjore te vendeve te zhvilluara aplikimi i te cilave ka rezultuar me zvogëlimin e numrit te automjeteve te pasiguruara**

#### **Organizimi i aktivitetit intensiv lobues në zvogëlimin-ndalimin e numrit të automjeteve të pasiguruara.**

Koordinimi me Ministrinë Punëve të Brendshme lidhur me automjetet e pasiguruara – ndërtimi i një strategjie të përbashkët për zvogëlimin e veturave të pasiguruara duhet marrë si model vendet e BE. Si model që kanë praktikuar metoda praktike mund të marrim për shembull modelin Zvicëran, Kroat si dhe atë Gjerman. Psh. në Zvicër, kompania e sigurimit në mënyre automatike e vazhdon sigurimin e veturës. Në raste të mospagimit të premisë së sigurimit nga pala edhe pas dy vërejtjeve menjëherë Policia do t'ia konfiskoj tabelat/në të kundërtën dëmin që do ta shkaktojnë këto automjete, do të ngarkohen dhe paguhen nga Policia e kantoneve, dhe jo nga Fondi Garantues.

Kroacia në vitin 2008 çështjen e mosregjistrimit të automjeteve e ka rregulluar me ligj, duke caktuar afat kohor prej 7 ditëve pronarit të automjetit të cilit i ka kaluar regjistrimi që të vazhdojë regjistrimin apo të iniciojë procedurën e ç'lajmërimit duke i dorëzuar targat e automjetit. Pas kalimit të afatit 7 ditor për pronarët e automjeteve të cilët nuk i kanë vazhduar regjistrimin e veturave ose nuk i kanë ç'regjistruar atëherë institucionet relevante i'a dorëzojnë gjobën në lartësi të konsiderueshme për mosveprim në përmbushje të ligjit. Ndërsa, modeli Gjerman çështjen e mosregjistrimit të automjeteve dhe përgjegjësitë lidhur me mosregjistrimin e tyre në rast shkaktimi të aksidenteve pas paralajmërimit nga Kompania Siguruese për skadimin e policës siguruese apo anulimit të saj, organi për regjistrimin e mjeteve ka më së shumti 1 muaj afat për largimin e automjetit nga qarkullimi dhe konfiskimi i tabelave.



## **Propozimet/Masat te cilat do te ndikonin ne zvogëlimin e numrit te automjeteve te pasiguruar ne Kosovë**

1. Policia e Kosovës të gjejnë modalitetet për marrjen e masave të nevojshme me qëllim uljen e numrin të automjeteve të pasiguruara. Zgjidhje më praktike do të ishte instalimi i kamerave në hyrje/dalje të qyteteve dhe vendeve të tjera me qarkullim të madh të veturave në Kosovë si dhe radarëve për kontrollim të shpejtësisë nëpër qytete, rrugë regjionale apo autostrada.
2. Nevoja e koordinimit ndër-Institucional.Vlerësojmë se bashkëpunimi i Intitucioneve Shtetërore me Byronë Kosovare dhe Industrinë e Sigurimeve është më se i nevojshëm pasi vetëm në këtë mënyrë do të zgjidhet problemi i automjeteve të paregjistruara/pasiguruara, i cili po vazhdon të mbetet problem sfidues brenda vendit tonë.
3. Të bëhet fushatë sensibilizuese nëpërmjet mediave televizive dhe atyre të shkruara për vetëdijësimin e shofereve lidhur me rrezikun e mosregjistrimit të automjeteve në kuptim të regresimit të shumave nga ana e tyre në rastet kur ata janë shkaktar aksidentesh.
4. Të insistohet tek organet kompetente që barra financiare të mos i takoj vetëm Fondit të Kompensimit por edhe Ministrive përkatëse për moszbatim të Ligjeve në fuqi për arsye të mosveprimt dhe vazhdimit të kësaj praktike të lejimit të qarkullimit të këtij numri tejët i madh mbi automjetet e paregjistruara.

Njëkohësisht, si Byro, konstatojmë se për periudhë të njëjtë 2010-2019 në masë të njëjtë humbje financiare rezulton të ketë edhe Buxheti i Kosovës, kjo për shkak mospagesës së taksave rrugore, TVSH-së tatimeve të ndryshme si dhe tarifave që përfshihen gjatë regjistrimit/sigurimit TPL të automjeteve në vlerë rreth 30 milona euro.